

VITI XV, NUMRI 5 / MAJ 2011

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



FOREVER

## Top European Countries

### #2 in 2010 Sales

*Congratulations and thank you to all the great distributors of*

## HUNGARY

(ALBANIA, BOSNIA & HERZEGOVINA, CROATIA,  
KOSOVO, MONTENEGRO, SERBIA, SLOVENIA)

*Oppe Maughan*





# Vëllezër në vështirësi

„E pabesueshme”- po mendoja duke parë pamjet e tërmetit shkatërrimtar në Japoni, ditën që unë dhe Gregg po përgatiteshim të niseshim për të marrë pjesë në takimin vjetor të miqve tanë në Japoni. Ashtu si edhe në letrën që Gregg më shkroi direkt mbas ngjarjes edhe mua mendja më shkoi menjëherë tek miqtë tanë atje, shumë nga të cilët i kam njohur prej dekadash. Nuk e dija nëse ata dhe familjet e tyre i kishin shpëtuar kësaj katastrofe?

Duke shkruar këtë letër, me kënaqsi ju bëj të ditur se si stafi dhe distributorët tanë atje asnjë nuk ka humbur jetë. Por shumë prej tyre kanë humbur shtëpitë dhe pasuritë e tyre, gjë që është e tmerrshme por që mund të kompensohet, ndërsa jeta e njeriut jo. Ngushëllimet e mia të sinqerta do të doja tu shprehja gjithë atyre familjeve që kanë humbur të dashurit e tyre.

Një ditë pas katastrofës fola me Annie dhe Rjay, që jetojnë afër zonës të fatkeqsisë. Të dy më thanë se ishte për tu marrë shembull sesi u sollën japonezët pas katastrofës. Ata qëndruan të disiplinuar, të organizuar dhe gjakftohtë. Shpesh kemi dëgjuar që pas katastrofave të tilla pason kaosi, dhe dëgjojmë shumë rrallë për njerëz të tillë fantastik sesi i përgjigjen të keqes.

Do të doja tju tregoja disa ndodhi që lexova në gazetë lidhur me këtë katastrofë:

Në qytetin Karakuwa të goditur nga cunami, të çvendosurit u mbledhën në një shkollë. Nuk kishin ujë, nuk kishin rrymë elektrike, nuk kishin lidhje telefonike. Noriko Sasiki (63 vjeç) u tha njerzve: „Gjithshka do ta ndajmë bashkë edhe sikur të mos na mjaftojë. Megjithse këtu jemi mbledhur njerëz të ndryshëm, nga familje të ndryshme, në hall të gjithë jemi vëllezër. E tillë është kultura jonë.”

Në qytetin Shizugawa që e rrafshoi plotësisht cunami zdrucktari Koji Sato që deri tani kishte jetuar me ndërtimin e shtëpive, tani përgatit arkivole. I trishtuar vetëm kaq mund të thotë: Nuk kam kohë të mendoj për fatkeqsinë që na ndodhi, mbasi të gjithë kohën jam i zënë me punë. Gjatë gjithë ditës më duhet të përgatis arkivole.

Në një vend tjetër ku është ngritur një strehë, me ndihmat e dërguara përgatisin pak ushqim për tua ndarë disa nxënësve. Kur u vënë ushqimin përpara, ata ulin kokën dhe vetëm kaq thonë: Faleminderit, faleminderit për gjithshka. Me këto që tregova doja tu trasmetoj mesazhin e shpresës. Në shtigjet e jetës sonë pamvarësisht nga sprovat që na i vështirësojnë hapat, duhet të jemi mirënjohës për atë që kemi dhe duhet të gjejmë mundësinë të ndihmojmë edhe të tjerët.

Ndër mend më vezulloi një thënie: Isha i mërziur që nuk kisha këpucë, por vetëm deri atëherë kur pash një tjetër që nuk kish këmbën.

Të mos harrojmë, se ilaçi më i mirë për vetqarjen është kur vemi në ndihmë të tjetrit. Greggu u ka kërkuar që të jepni sa keni mundësi, që të mund të ndihmohet Japonia. Me dashuri që vjen nga thellësia e zemrës edhe unë ju lutem juve. Një muaj mbas katastrofës të Japonisë, kur ata njerëz të mrekullueshëm kanë filluar të rindërtojnë jetën e tyre, mos harroni që në botë ka edhe shumë njerëz të tjerë që kanë nevojë për ndihmën tuaj. Nuk duhet të shkojmë larg, shumë prej tyre që kanë nevojë jetojnë afër nesh. Ashtu sikurse e kam përmendur edhe shumë herë të tjera, shpesh ndihma më e mirë është ti njihni ata me mundësitë fantastike që u ofron jetës së tyre FOREVER-i.

Me shpirt edhe unë atje jam me vëllezërit tanë japonezë, dhe do të falem për ta. Besoj se ky përkushtim i paegoizëm, me të cilin janë të lidhur me njeri tjetrin dhe me vendin e tyre, do ta gjejë shpërblimin. Jam i sigurtë se do ta rindërtojnë jetën e tyre dhe do të jenë më të fortë se dikur. NUK KA KUFI kur njerzit janë bashkë, dhe punojnë me vetmohim për një interes madhështor.

REX MAUGHAN  
I JUAJI PËRGJITHMONË





## DITËLINDJA E 14

**F**LP-ja e Hungarisë ka hyrë në moshën e adoleshencës. Si rezultat i një pune të palodhur dhe të vendosur krijuam së bashku në Europë një nga sipërmarrjet më të mëdha të punës në rrjet. Duke u kthyer mbrapa mund të shohim gjithë historinë që nga hapat e para – kur bashkpuntori ynë në nivelin e safirit József Szabó, i vendosur provoi të njihet me produktet e Forever-it Hungarinë dhe vendet përreth të Europës lindore – deri në ditët tona, kur Miklós Berkics, Attila Gidófalvi dhe Kati si menaxherë diamant u shndrruan në distributor të rëndësishëm dhe kur në të gjithë Serbinë, menaxher diamantër Stevan dhe Veronika Lomjanski u bënë vendimtar në veprimtarinë e punës në rrjet. Ëndrrat e kohës së fëmijërisë së 1997 filluan ngadalë të bëhen realitet. Tashmë FLP e Hungarisë së bashku me vendet e rajonit të Europës jug-lindore kalojnë e para si sipërmarrje drejtuese dhe këtë pozicion po e ruan për më shumë se pesë vjet. Shumë vetë më pyesin, cili është sekreti i këtij suksesi të vazhdueshëm, i asaj, që në mes të krizës ekonomike – në të cilën sipërmarrje të vogla dhe të mëdha falimentojnë – Forever-i edhe nga kjo del me bilanc pozitiv... Cili është sekreti, që edhe firmat e mëdha, sipërmarrjet e mëdha e gjejnë të ardhmen e tyre te Forever-i? Për këtë di një përgjigje shumë të thjeshtë: ekziston një njeri, Rex Maughan, drejtori i përgjithshëm i firmës, i cili në 1978 krijoi një sistem marketingu dhe një familje produktesh të tilla, e cila me kalimin e viteve pati në vazhdimësi vetëm zhvillim, dhe ky zhvillim me rritje të përmasave botërore në kuptimin e mirë të fjalës e ndërtoi Forever-in në një sipërmarrje të madhe, ndërkohë që në qendër mbetet njeriu, falë strategjisë që merr parasysh qind për qind nevojat e individit, sistem unik në krahasim me botën. Në këtë strukturë roli i individit është vendimtar, dhe Forever-i çdo gjë e bën në varësi të saj. Nëse do të quhej sekret, atëherë ky është sekreti, këtë Rex-i e përkufizon në mënyrë të thjeshtë: Forca e Forever-it është forca e dashurisë.

U kthyem në vendin tonë nga pjesëmarrja takimin World Rally të Europës dhe mund të themë qetësisht, që secili, që ndodhej atje, e ndjeu veten shkëlqyeshëm. Ishte mirë që në Vjenë të ndjehesh hungarez, serb, kroat, boshnjak apo slloven, sepse ky takim foli për ne, për rezultatet tona. Hungaria dhe rajoni i Ballkanit morrën medaljen e argjendtë për realizimin e xhiros së përgjithshme. Miklós Berkics, Attila Gidófalvi dhe Kati ishin ndërmyjet 10 distributorëve më të mirë të Europës, po kështu mund t'i gëzohemi klasifikimit të diamantit, çeku i Miki Berkics është me medaljen e artë në Europë, dhe ne merituar gjithashtu Spirit Award: ne jemi më të mirët!

Lind pyetja: si të ecim më tej, si mund t'i çojmë edhe më tej këto rezultate, si mund të caktojmë objektiva më të larta, si mund të përgatitemi përsëri për kampionatin europian. Sigurisht është e mundur, dhe duhet gjithashtu, sepse çdo ditë, çdo minutë është një sfidë në jetën tonë. Forever-i çdo ditë na jep mundësi të reja në dorë me xhelin e aloe verës, dhe me zhvillimin e produkteve gjithnjë e më të reja. Ndërsa FAB-i dhe Argi+ vë para nesh sfida të tjera pa kufi, dhe n.q.s. të gjithë këtë do ta kombinim me bagazhin e gjërë të njohurive mbi marketingun, atëherë çdokush do të ndiente atë përgjegjësi, që Rex Maughan ka vendosur në duart tona.

Uroj, që jeta e secilit në çdo sekondë të jetojë me këtë mundësi, të realizojë ëndrrat dhe të mund t'jua dhurojë edhe të dashurve, fëmijëve apo nënave. Gëzuar ditëlindjen e FLP Hungarisë! Perpara FLP Hungarisë!

DR. MILESZ SÁNDOR  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



BUDAPEST, 2 PRILL

# Success Day

LAJMETË GËZUARA, FESTIM DHE  
NJË BASHKPUNIM I VEÇANTË: FLP  
E HUNGARISË EDHE NË DITËN E  
SUKSESIT TË MUAJIT PRILL E TREGOI  
VETEN.

**D**r. Ilona Juronics dhe Géza Varga soaring manager morrën rolin e të zotërve të shtëpisë e bashkë me të mikrofonin e drejtuesve të programit. Drejtimi i ditës dëshiron prej nesh të paktën po aq vrull, energji dhe mençuri, sa një seminar profesional. Ata atje nuk flasin për veshitësi, sikurse thonë, çdo minutë e jetës së tyre në Forever është kënaqësi, dhe megjithëse e marrin seriozisht, po aq e mbajnë si lojë, ku secili mund të jetë protagonist. “Filloi me një vendim, me një ëndërr” – thotë Géza, dhe ëndrra arriti deri atje, sa sot ata të dy prezantojnë **Dr. Sándor Mílesz** - drejtorin e përgjithshëm, apo siç e tha Ilona “xhonglerin e kohës”.

Dr. Sándor Mílesz tashmë nuk flet për ëndrrat, por për realitetin, edhe n.q.s. për shumicën tingëllon si ëndërr, të ardhura që shtohen nga 400 mijë deri në 10 milion. „Flas për të ardhura mujore” – përcakton drejtori i përgjithshëm, që të mos mbetet e dyshimtë, **Rex Maughan**- kishte të drejtë, kur tha që nuk ka kufij. Për këtë duhet sigurisht një zhvillim i ndërgjegjshëm dhe rinovim i aftësive. Që ky rinovim është i pranishëm edhe në ofertën e produkteve, atë e prezantojnë menjëherë zonjat në sfond me fustane në formë FAB-i që bien në sy: në dorë mbajnë nga një produkt të ri Forever-i nga paleti i periudhës së fundit.

Por të gjithë e dimë, që edhe produktet aq të mira nuk mund të lihen në vetvete: çdo gjë varet nga ajo, a ka burim të mjaftueshëm njerëzor në transmetimin e mesazhit.

-Kush janë ata, që ndodhen për herë të parë në Ditën e Suksesit? – pyet drejtori i përgjithshëm dhe një e treta e sallës së mbushur plot ngrihet nga vendi. Ne e ndjenim, por është shumë më mirë kur e shikon me sytë e tua: vijnë pasardhës të rinjë, zgjerohen grupet. Dhe jo vetëm ato të biznesit, por edhe grupe të tilla të vogla, si familja: garancia tjetër e rezultateve tona. – Sa janë mes jush, që e kanë planifikuar vetë, sa fëmijë





dëshirojnë? – hedh pyetjen tjetër Dr. Sándor Milesz dhe tani kandidatët janë më të shumtë.

– Dhe kush janë ata, që sot rrisin aq fëmijë sa kishin planifikuar? Menjëherë, më shumë se gjysëm pakësohet numri – kjo sigurisht është për tu menduar. Sándor-i thekson: nuk ka zhvillim as në biznes, as në jetën private pa gjenerata pasardhëse. Siç thonë, „e ardhmja është brënda nesh”.

Më pas përshëndet në veçanti të rinjtë „Jeni në vendin e duhur, keni marrë vendimin e duhur, pasi këtu mund të bëheni, ata që gjithmonë keni dëshiruar të jeni.” Ndërsa për këtë në emër të FLP Hungari ofron të gjithë ndihmën: „keni mbas vetes një mbështetje fantastike, që ju ndihmon në çdo gjë. Vendi mbështetës më i fuqishëm në botë” - thekson drejtori i përgjithshëm, dhe tani këtu nuk llogariten numrat, por potenciali që fshihet në firmë, në komunitet, në dijen e përbashkët. „Ju jeni e ardhmja, përdorni të gjithë ato, që fati, Rex Maughan dhe kjo sipërmarrje ju ka vendosur në duart tuaja” - përfundon drejtori.

Dhe me qënë se është fjala për gjeneratën e re, përsëri mund të shohim qartë dëshminë e përkrahjes së talenteve nga FLP-ja. Një shfaqje me të vërtetë cilësore shkrin atmosferën: Shkolla e muzikës Leo Weiner dhe Shkolla e mesme profesionale e artit muzikor klasa e veglave muzikore me me vrull ngjitet në skenë me pjesë befasuese.

Nga euforia nuk do të ketë mungesë as më vonë, vazhdon rradha e njoftimeve të rëndësishme: **Dr. Edit Révész Siklósné** do të vazhdojë më tej të aktivizohet si presidente e grupit të mjekëve konsulentë, ndërsa





**Miklós Berkics** bën thirrje për të ndihmuar njerëzit e prekur nga tërmeti në Japoni. Auditori, ashtu si dhe në të shkuarën e afërt në kohën e katastrofës, edhe tani ndihmon: në sallë rradha e gjatë e dhuruesve presin te tavolina e vogël. Miklós-i përkthen premtimin e Rex Maughan: presidenti i firmës do të dyfishojë shumën e mbledhur, ose pranë çdo forinte do të shtojë edhe një tjetër. Në ndihma marin pjesë shpejtë drejtori i përgjithshëm dhe diamantët, me guxim mund të flasim ne numrin shumë jo vetëm për **Attila Gidófalvi dhe Kati-n**, jo vetëm për për çiftin Lomjanski, por dhe për krenarinë tonë të tretë, Miklós Berkics. Nuk është sekret: së bashku me lektorin e ftuar Kim Madsen në Ditën e Suksesit të ardhshëm do të festojnë së bashku katër diamant në ditëlindjen e 14 të FLP Hungari.

Këto 14 vite mund tju falenderohen shumë gjërave, dhe sidomos për atë që nuk ka pasur rezultate dosido. Një gur themeli në suksesin e rajonit janë pa dyshim produktet. Për probiotikët flet **Dr. Zsuzsanna Baranyi-Tóth** senior menaxhere. Fillon me shëndetin dhe sistemin e shëndetshëm të tretjes. Jo shumë kohë më parë u bë publike, që krahas gjallesave që mbajnë sëmundje, ka edhe baktere që janë miq të njeriut, bile në sasi shumë të mëdha jetojnë në organizmin tonë (përbëjnë 1,5 kg të masës së trupit tonë). Nga doktoresha dëgjuam për asimilimin e probiotikëve, prebiotikëve dhe simbiotikëve, për efektet dobiprurëse në sistemin imunitar. E dimë, si krijohet flora e zorrëve e shëndetshme, në çmënyrë funksionon, cilët faktorë ndikojnë mbi të, dhe për çfarë shkaqesh duhet dyshuar nëse do të prishet ekuilibri.

Doktorët e aktivizuar në Forever (që shtohen gjithnjë e më shumë) dëshmojnë me shembuj praktik, se sa fushë e rëndësishme është kjo e të jetuarit në mënyrë të shëndetshme.

Seminari i menaxherëve **Edit Kádár Sándorné dhe Zsolt Sándor** filloi kështu: „Varet prej teje, ashtu si niveli i menaxherit u var prej nesh. Secili ka rrugën e tij, kështu që jepi një shans vetes dhe do ta gjesh rrugën e shtëpisë. E meriton këtë shans, ashtu siç e merituar edhe ne” - e përmbledh Edit-i, më pas Zsolt-i shton, që ta kuptojnë më shumë: “FLP-ja nuk shikon se nga vjen, por vetëm, ku do të shkosh”.



Dhe që të japi edhe këshilla më të prekshme Zsolt-i flet për detyrën e vërtetë në fund, për marrdhëniet e sponzorit dhe të drejtuesit të grupit. “Kjo është sipërmarrja jote, mos prit nga sponzori!”-dëgjohej thënia kryesore. “Edhe ne morrëm shumë përgjigje jo, edhe për këtë përgatitu. Por ja vlejti: falë FLP-s, që pamë detin”.

Dhe nëse flitet për det, çifti i referohet dinamikës së biznesit që vihet re kohët e fundit: “Këtu është vala e tretë dhe ne duam të jemi brënda!”

Ndërkohë mësuam, që në vazhdimësi të ditës shuma e parave të mbledhura për ndihmë e arriti milionin. Është kjo, që e bën funksionale këtë sipërmarrje: nuk punon vetëm për vete, por përkrah edhe të tjerët, edhe kur bëhet fjalë për bashkpunorë, apo për banorë të një vendi të largët që kanë patur fatkeqësi.

Një grup tjetër i shkollës profesionale të artit muzikor, me quintetin e tij luan me instrumentat frymorë, ndërsa pas kësaj **Tibor Éliás** soaring menaxher gjallëron auditorin.

Informacion, produkt, grup – rradhit mjeshtri i treshes Tibor, i cili prej 13 vjetësh provon, që këtu munda ti realizojë të gjitha, ato që ëndërroi në fëmijëri. Por për këtë duhet punuar – shton – kjo punë ngrihet mbi ndershmëri. „Nuk mjafton fjala, duhet vepra, sepse njerëzit nuk hyjnë në FLP, por tek ty. Dëshiro, që të jetë mirë për ata dhe atëher do të jetë mirë edhe për ty!”

Dimë akoma, që nga konsumatori do të dali krijuesi më i mirë i rrjetit dhe që nga biznesi do të një stil jete, një mënyrë jetese komplekse. Sipas rrëfimit të tij Tibor-i ka tashmë tre familje: shtëpinë, FLP-n, dhe Hungarinë. „Edhe i vogli duhet vlerësuar, motivuar, ti vëmë qëllim” - përmbledh fjalën e tij soaring menaxheri.

Ndërsa ata që caktojnë një objektiv, herët a vonë do ta realizojnë, këtë e vërteton dhe listat e emrave të Klubit të Sundimtarëve, klasifikimi i menaxherëve, asistent menaxherëve dhe supervisorve, marrja e çmimeve nga pjesëmarrësit në programin e makinave, festimi i Eagle menaxherëve dhe antarëve të Klubit të Presidentit.





Rezultatit më të mirë e dhanë çifti **Lapicz, Orsolya dhe Tibor**, që zunë vendin e parë në listën e sundimtarëve. Tibor-i me thjeshtësi thotë vetëm kaq: „100 pikë jo-menaxheriale kjo nuk është shumë, n.q.s. punojmë me ata, që besojnë në ëndrrat e tyre”.

**Ferencé Tanács dhe Ferenc Tanács** senior menaxherë gjithashtu kanë gjetur të dashuruarit e tyre, sigurisht në rradhë të parë njëri-tjetrit: histori pesëdhjet vjeçare që fillon me lidhjen martesore vazhdon me lindjen e dy vajzave deri në përpjekjet e biznesit. Ndërsa në fillim as nuk donin të ndërtonin rrjet...

“Gjithmonë parashikonim, planifikonim, si përfundim këtu filloi jeta jonë e dytë” - thotë Ferenc, sipas të cilit sekreti i tyre është, që asnjëherë nuk i lënë njerëzit të largohen. Edhe e shoqja mendon në mënyrë shumë praktike: “m.q.s. nuk mund t’ju shmangemi problemeve, le të jemi zgjidhës të problemeve!” - na siguron ne. Sikurse thotë, më pas duket që kemi marrë vendime të mira apo jo, e rëndësishme është që të dimë të trajtojmë situatën. “Ne e mësuam mësimin, sepse jemi këtu” -thotë, më pas duke ju referuar të shkuarës së afërt flet për atë që në zemra të mos ketë mërzitje. “I përkasim njëri-tjetrit, ndahemi... nuk jemi pa njëri-tjetrin. Por







për ne nuk ka tjetër dhe nuk do të ketë tjetër: këtu duam të jemi. Kushdo është i zëvendësueshëm, dhe ne kemi akoma rezervat tona. Është mirë që i përkasim njëri-tjetrit, ky është arkivi Forever”.

Pas fjalës së fundit që shkaktoi gjallëri rradhën e pati një njeri jo më pak popullor, i cili, sipas drejtuesve të lartë do të jetë në pesëshen e parë të diamantëve: Tamás Budai soaring menaxher.

Tema ishte pjesë e teknikës së ndërtimit të biznesit. Detyra pothuaj është e pamundur, të japësh brënda kësaj kohe një kompleks njohurish të tilla, por ndoshta mund të mjaftojë kjo bazë e vogël për të qartësuar disa mendime të rëndësishme. Në lidhje me nisjen përmenden disa gjëra të rëndësishme: mposhtja e mentaliteteve të këqija, ambjenti ideal i prezantimit, rrethi i të ftuarve, prezantimi i produkteve, pjesa e reklamës dhe marketingut, administrimi, rikërkimi... Siç thotë Tamás-i, nuk jep gjithë recetat, por tregon vetëm metodat e veta, por secili duhet të gjej atë, që funksionon tek ai. Dhe sigurisht: “nuk duam të pasurohemi shpejt, por shumë” - është një thënie inteligjente. Megjithëse Tamás-i di shumë, para kualifikimit të asistent supervizorve, ai na njeh me një nga pikënisjet e rezultateve tona: “Nuk heq dorë nga të mësuarit, dhe gjatë 10 vjetëve vazhdimisht mësoj gjëra të reja. Ky është një zhvillim i pafund.”- shprehet ai

*Tashmë kushdo mund të shijojë formën dhe shërbimet e reja të FLP TV!  
Takimin e Vjenës dhe World Rally tashmë në FLP TV mund ti shikoni në tre gjuhë!  
Si nëpërmjet cilësisë dhe shumëllojshmërisë të programeve ne synojmë ta rinovojmë atë sa më shumë.  
Grupi i FLP TV ju uron shikim të mbarë të programeve!*

*Sándor Berkes  
FLP TV*





# Të dashur miq të Foreverit!

Ashtu si ju edhe unë qëndroj i trodnitur para katastrofës të ndodhur në Japoni. Më kujtohet kur në orët e para të lajmeve të mëngjezit kur dëgjova për herë të parë që një tërmet i fuqishëm kishte rrafshuar deri në fund pjesën verilindore të Japonisë. Duke dëgjuar lajmet e para tronditëse përpiqesha të kuptoja dhe të mendoja ku janë njerzit tanë, dhe në cilën pjesë të Japonisë ndodhen distributorët tanë. Për fat të keq nuk duhej të vrisja shumë mendjen që të bindesha se shumë prej tyre ndodheshin në zonën e prekur nga tërmeti. Menjëherë provova të hyja në lidhje me drejtorin e FLP në Japoni që të mësoja gjëndjen realisht dhe se si mund të ndihmonim. Rjay Lloyd dhe bashkëshortja e tij Annie ndodheshin afër Tokios. Me ta munda të lidhem vetëm mbas disa orësh i shqetësuar. Më tregoi se nga vendi ku po qëndronin ata, epiqendra e tërmetit ishte 300 km dhe ai ishte ndier me forcën 7 ballë edhe në zyrën e Tokios.

Godina ishte lëkundur 45 cm, por falë zotit, në zyrë kishin ndodhur disa dëmtime dhe nuk kishte patur njeri të dëmtuar. Menjëherë u bë e qartë se kishim të bënim me një situatë shumë më serioze sesa në një tërmet të zakonshëm. Me mendimin e njerzve tanë në Japoni, me zemër të trishtuar, takimin Rally të Japonisë që ishte i planifikuar për mbas një jave e shtymë. Në këtë mënyrë mund të përqëndrohemi me forca më të shumfishuara se si mund të ndihmojmë.

Për çudi kolegët tanë që punojnë në Japoni në mënyrë të sigurtë na sinjalizuan nga distributorët tanë nuk kishte humbur jetën asnjëri. Por shumë prej tyre kishin humbur shtëpitë dhe pasuritë e tyre. Disave prej tyre u ishte rrafshuar gjithshka kishin. Në kë gjëndje të tmerrshme secili prej tyre kishte nevojë për çfardo ndihme humanitare. Me kënaqsi ju bëj të ditur se Foreveri nuk mund të rrinte duarlidhur. Menjëherë zbrazëm magazinat e atjeshme dhe mallin ua dhamë distributorëve tanë, që me ndihmën e rrjeteve të tyre të mbrinin tek ata që kishin më shumë nevojë. Në ditët që pasuan dërguam nga jugu i Japonisë për në zonën e goditur 3 kamionë të tjerë me mallra. Do të bëjmë gjithshka për të ndihmuar ata që i zu fatkeqesia. Por kemi nevojë edhe për ndihmën tuaj që të bëjmë edhe më shumë për ta.

Juve, si pjestarë të familjes Forever, ju lutemi që të bashkoheni me ne, të ndihmojmë Foreverin e Japonisë, të cilët i janë bashkuar solidaritetit humanitar për lehtësimin e dëmeve në vëndin e tyre. Jemi të sigurtë se në qoftë se çdo njeri ndihmon me aq sa ka mundësi Forever Giving Japanese Relief Effort (Grupi ndihmave humanitare) do të jemi në gjëndje të grumbullojmë deri 25 milion jen. Në qoftë se realizohet ky objektivi, Rex është i gatshë që edhe ai vetë të kontribuojë po me kaq jen. Kjo do të thotë që japonezëve të zënë nga kjo fatkeqsi tu vejë një ndihmë prej 50 milion jen. Forever Giving ju garanton se kjo ndihmë do të vejë 100% tek të dëmtuarit nga tërmeti. Organizata jonë e ndihmës me ndihmën e Forever Japoni, kërkon partnerë seriozë, me bashkpunimin e të cilëve të mund të mbështesim ata që kanë nevojë më shumë për këtë ndihmë

Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit [www.forever-giving.org](http://www.forever-giving.org) dhe jepni aq sa janë mundësitë tuaja. Jemi të qartë se kudo në botë ka nevoja për ndihmë dhe në kohën e sotme ndoshta nuk është aq lehtë të falësh, por nuk ka rëndësi të sakrifkosh, rëndësi ka të japim sa më shumë. Të paktën aq sa kemi mundësi.

Ju faleminderit që po bashkoheni me ne.

GREGG MAUGHAN  
PRESIDENT I FLP

FOREVER LIVING PRODUCTS INTERNATIONAL



# DASHURIA **NO LIMITS** E MUAJIT MAJ

**P**o përshëndet vera e vërtetë e Foreverit! Çelin lulet, lulëzojnë pemët frutore, fryn lehtë fladi i pranverës, na përkëdhel rrezja e diellit, një botë plot dashuri. Më 21 të këtij muaji, në Ditën ndërkombtare të Suksesit, festojmë vitin e 14-të të sukseshëm të rajonit tonë. Të rinjtë dhe mijra të rinj të perjetshëm i presim me parti të pijes FAB. Në datën 20 zhvillohet takimi i dytë i hapur më i madh i Ditës së Shëndetit në Budapest, ndërsa në datën 22 përshëndesim menaxherët diamantë në kështjellën historike të Szirakut. Periudha për kualifikimin Holiday Rally, fillon më 1 Maj dhe zgjat deri në 31 Gusht. Forevera të vjetër e të rinj, mos humbisni rastin, ngjitni shkallët e planit të marketingut! – për vete e për skuadrën tuaj dhe për një pushim të mrekullueshëm falas „all inclusive” në Porecin e bregdetit kroat. Nisuni vetë dhe nisni edhe bashkpunëtorët tuaj të rinj sipas stilit 2 pikësh me kutinë e veçantë Travel Touch. Kjo paketë produktesh 2 pikëshe, më popullorja, është një nga mjetet më moderne të Foreverit. Me çmimin e një bicikle, ju bëheni zot i një sipërmarrje ndërkombtare me të ardhura të perjetshme dhe pas kësaj mund të blesh me 30% më lirë, në Hungari fiton falas anëtarësinë ATS, me anën e të cilës mund të udhëtosh me gjithë familjen kudo në botë me 20-50% më lirë, madje mund të sigurosh telefonin tënd Forever ku mund të kursesh disa qindra euro në krahasim me faturën e deri tanishme telefonike.

Ke edhe 4 muaj që të ndryshosh jetën tënde – sigurisht në qoftë se do vërtet. Tek ne asgjë nuk është e detyrueshme, vetëm thjeshtë ia vlen. Pse merrret kutia Travel? Secili për arsyen e vet. Ka nga ata që duan të blejnë me çmim më të ulët, ka nga ata që duan të fillojnë biznesin e tyre. Dikush tjetër thjeshtë për telefonata më të lira apo mundësi udhëtimi pa kufi kërkon ofertën 2 pikëshe të Foreverit.

Ka edhe nga ata që e shfrytëzojnë si mjet pune, dhe me të drejtë lëvdohen me të, sepse janë krenarë për vendimin e tyre, ua tregojnë edhe të tjerëve kutinë, e hapin atë, ta shohin edhe të tjerët shpirtin e Foreverit. „Kutia e magjishme” nuk është vetëm hambar i produkteve më popullore të Foreverit. Kutia Touch është kontakti i parë me jetën-është simbol i biznesit tënd, është hapi i parë i vendosur në perandorinë e mundsive të pafundme të Foreverit, është fillimi i të ardhmes tënde stabël në „euro” që mund ta planifikosh dhe mund ta zgjerosh më tej. Kujdes! Mund të të lindin edhe dyshime subjektive, frikë, pengesa, e justifikime që janë pjellë e imagjinatës të rastit, sidoqoftë Foreveri nuk ka kufij (No limits!).

**Radóczy Tibor**  
soaring menaxher  
Drejtor Rajonal



# Success Day

BEOGRAD 19 MARS 2011

PO ZGJOHET DHE PO  
LULËZON BIZNESI  
ASHTU SI ZGJOHET  
EDHE NATYRA NË  
PRANVERË. SHTËPINË  
E SINDIKATAVE NË  
BEOGRAD E KISHIN  
MBUSHUR PLOT  
MIQTË E FLPTË  
CILËT EDHE  
NËPERMJET KËSAJ  
TREGONIN SE  
KISHIN BËRË  
ZGJEDHJEN E  
PROFESIONIT  
MËTË MIRË.



**T**akohemi me drejtuesit e këtij takimi, Senior Menaxherët **Olga dhe Miodrag Ugrenovic**. Ekonomia dhe marketingu nuk janë një fushë e panjohur as për olgën dhe as për Mison, por mundësitë e biznesit të madh të FLP i kanë njohur prej kohësh. Të dy janë fitues disa herë programeve stimuluese, dhe pas tyre qëndron ushtria e kënaqur e konsumatorëve dhe e bashkpunëtorëve.

Traditë, besim, cilësi, rritje e vazhdueshme e xhiros, pages bonusi e rregullt., prezencë në mbarë botën, kënaqje e konsumatorëve...duke përmendur vetëm disa nga avantazhet që siguron FLP. Falë të shkuarës më së 30 vjeçare, bvesimi i konsumatorëve dhe bashkpunëtorëve tanë është i pathyeshëm dhe e dinë se bëhet fjalë për një firmë të tillë, të cilën edhe në rang botëror e vlerësojnë lart. **Branislav Rajic** si perfaqësues i FLP Serbisë na tregon se aktualisht firma jonë ofron në Serbi paletën më të mirë të produkteve dhe të sherbimeve. Teknologjia më moderne në sherbim të cilësisë ja manuali kryesor i programit të produkteve të Foreverit. Menaxheri Sinisa Blaskovic na njeht në detaje me karakteristikat dhe efektet e produkteve tona më të reja.

Nëpërmjet valleve dhe koreografisë të ansamblit kulturor „**Stanko Paunović**” që ka një traditë mbi 50 vjeçare nuk na lë të harrojmë trashëgimninë kulturore të vendit tonë. Nëpërmjet kësaj na shfaqin një svit duke na treguar bukurinë e valleve popullore serbe, gjithshka në mënyrë harmonike dhe gazmore si një hyrje e merituar e këtij takimi.

Si na ndihmojnë këto produkte në pranverë? Si ta ruajmë ekuilibrin e organizmit tonë në pranverë? Thjeshtë nëpërmjet përdorimit të përditshëm të produkteve cilësore të FLP, na thekson menaxherja **Dr Snežana Kontra**.

Produktet tona flasin vetë, vetëm duhet pak guxim, që dikush të shkojë tek njerzit dhe tua sqarojë atyre, se si me përdorimin e vazhdueshëm dhe sistematik të tyre mund ndikojmë në cilësinë e jetës tonë. **Dr. Olivera Miškić**et me pervojën e fituar me produktet na nxit që në përdorimin e tyre të inkurajojmë blerësit, ndërsa kolegët mjekë që gjatë punës të tyre produktet tona ti përdorin për atë që vëzhgimet dhe përvojat praktike tua transmetojnë njerzve, Më besoni motoja e punës tonë është rekomandimi i blerësit të kënaqur.





Në skenë e Shtëpisë të Sindikatave ngjiten supervizorët e rinj , duke shpresuar që bashkë me skuadrat e tyre ti shikojmë në nivele më të larta.

Pak punë pastaj pak argëtim...arrijmë tek **Igor Staravić** , i cili me orkestrën shoqëruese me këngën e tij që na ngre të gjithëve në këmbë ndan energji pozitive me publikun e entuziazmuar.

„A ke pasur mundësi të tilla të verteta në jetë? Unë për shumë kohë nuk e kam ditur një mundësi e tillë, ndërkohë që luftoja për një shëndet më të mirë/ menaxheri shprehet **Milan Mitrović Pavlović**. I vetmi shkak që ndërmyet ne të gjallëve nuk është pjestar i FLP, është që jo gjithkush e njeh këtë sistem apo që nuk është gati të çajë shabllonin me të cilin është mësuar. Por fatmirësisht gjithmonë gjenden individë të tillë të guximshëm, që e rritin forcën e grupit të tyre.

Nga Thomai mosbesues tek blerësi i kënaqur e deri tek menaxherja e sukseshme, shkurt kështu mund ta karakterizojmë veprimtarinë 10 vjeçare në firmën tonë të Zafir Menaxheres **Irena Dragojević**. Ngritje dhe rënie, shqetsim dhe sukses janë bashkudhëtarë të çdo biznesi, por puna këmbëngulëse për arritjen e objektivave, dëshira e zjarrtë për ti kaluar vështirësitë e bën më të lehtë punën në FLP. Falnderojmë Irenen për bisedën frymëzuese dhe me objektiva të arta, ku në fund marrim edhe përgjigjen e pyetjes, se si mund të jemi të sukseshëm në këtë biznes?

Si dhe nga vjen paraja në FLP? Po, gjithshka rreth nesh duhet ta bëjmë sipas politikës të biznesit. Të ardhurat vijnë nga produktet cilësore dhe nga një plan marketingu transparent, ku me çmimet e distributorit të ri dhe nëpërmjet produkteve të reja sigurohet një fitim i shpejtë, i ligjshëm dhe i drejtpërdrejtë, kësaj i kontribuon edhe ajo që në çdo vend ku është prezent FLP, luhet me të njëjtat rregulla loje. Nga më të mirët vetëm gjërat më të mira mund të mësojmë, prandaj e presim me falnderime transmetimin pa egoizëm të njohurive të saj, nga Diamant Menaxherja **Veronika Lomjanski**.





Ndërsa asistent menaxherëve të rinj të sapokualifikuar u jepet distiktivi i shqiponjës si simbol i synimeve të larta dhe i një biznesi të lirë me shpresë që shumë shpejt do të arrijnë rezultate që tërheqin vëmendjen në FLP duke u gënjtur një niveë më lartë me bashkëpunëtorët më sukseshëm.

**Branislav Rajić**  
Drejtor i FLP Serbi

Takimi tjetër më i afërt do të jetë në Shtëpinë e Sindikatave në Beograd më 28 Maj





## AMVISAT E SHTËPISË FOREVER

**Dihet që burra të ndritur kanë patur një rol të veçantë në formimin e marketingut në rrjet (MLM) në ideimin e një modeli biznesi të efektshëm. Por në „historinë e lashtë” të ndërtimit të sukseshëm të rrjeteve kanë patur rolin e tyre edhe gratë. Pikërisht si amvisa. Që sistemi të jetë i sukseshëm duhet edhe besimi, mençuria dhe këmbngulja e amvisave. Të mos mjaftohemi me përmendjen e thjeshtë të rolit të tyre. Të mendojmë e të kuptojmë esencën e suksesit të tyre, atëherë do të kuptojmë diçka nga esenca e MLM. Pse figura e amvisave ka rëndësi? Çfarë mund të mësojmë në ndërtimin e rrjeteve duke patur parasysh ato?**

Dihet se në fillim zonjat ishin të lidhura me shitjen direkte, por duke kaluar tej saj ato filluan të krijojnë rrjetet e tyre të sukseshme.

Tanimë, që nga prezantimi i parë i shitjeve ka dalë se krahas ekspertit prezantues, një rol shumë të rëndësishëm kishte amvisa e shtëpisë e tërhequr diku në qoshen e dhomës ku bënte çajin duke buzëqeshur. Ajo ishte mikpritsja. Me ftesën e saj kishin ardhur të tjerët. Buzëqeshja dhe vëmendja e saj e bëri të besueshëm lektorin „profesionist”. Pra në të vërtetë, amvisa ishte figura kryesore! Çdo të thotë amvisë, si figurë kryesore e biznesit? Me siguri dhe për këtë ky është modeli i mrekullueshëm i biznesit, sepse tashmë që nga kohët e para biznesi dhe vlerat e jetës personale kanë lidhje të veçantë.

### BESUESHMËRIA

Në fillim prezantimi i produkteve bëhej në rrethe të ngushta. Amvisa fton shoqet e saj, me të cilat sigurisht kishte lidhje, dhe tek e cila kishin besim, e pranorin dhe e donin. Domethënë ishte e besuar para tyre, sepse prej kohësh e kish fituar këtë besim në komunitetin e saj, me fjalën, me veprat por edhe me kekun e saj. Fliste po atë gjuhë si edhe ato, kishte po atë mënyrë jetese, po atë sjellje, po ato zakone- e kuptonin tamam njera tjetrën. Ajo u kishte dhënë kampionet e produkteve, ajo ua kishte bërë të besueshme produktet dhe personin lektor. Pra ka qënë e qartë dhe ashtu është edhe sot, që besimi tek lidhjet personale, është shumë herë më i rëndësishëm se prezantimi me ekspertë. Po kështu amvisat e lidhura me kohë me biznesin, tashmë jo vetëm rekomandojnë. I rëndësishëm ishte informacioni i ri, por po aq e rëndësishme ishte edhe buzëqeshja që na jepte e zonja e shtëpisë që na priste. Ka qënë dhe është e qartë edhe sot se besimi tek lidhjet personale shumë herë është më i rëndësishëm se prezantimi profesionist. Njëkohësisht amvisat e lidhura me këtë biznes me kohë, tashmë rekomandojnë jo vetëm produktet, por fillojnë të tërheqin në këtë biznes edhe shoqet e tyre – dhe prej këndeje nis për to ndërtimi i rrjetit.

### SIGURUESËTË EKUILIBRIT

Që të të mbeten në mjedisin e tyre edhe më tej të besueshme, tashmë të zonjat e shtëpisë që veprojnë edhe si zonja të biznesit, duhet të jenë të shkathëta në prezantimet, në tërheqjen e njerzve, domethënë në ndërtimin e biznesit. Por e gjithë kjo nuk mjafton: edhe si të vlerësuara ato do të duhet të mbeten zonja të mira shtëpie! Do tu duhet ta ruajnë këtë ekuilibër shumë të rëndësishëm. Nuk duhet të ngushtohen në botën e prezantimeve, sepse janë ushqyer nga kapitali i tyre personal. Cilësia e pites apo kulaçit, nuk mund të ketë ndryshuar- ky ishte interesi bazë i biznesit. Ky pra është ekuilibri: të ecësh përpara, të zhvillohesh në biznes, por të mos shkëputesh nga bashkësia që të siguroi miqtë dhe avantazhet. Edhe sot magjia e ndërtimit të rrjeteve është ekuilibri: sa më mirë të ecësh në biznes aq më shumë duhet të ruash sjelljet e tua, vlerat e tua qytetare dhe aq më shumë nuk duhet menduar vetëm për biznesin. Në qoftë se e di që biznesi nuk sjell vetëm para por edhe vlera morale, atëherë me siguri do të kesh edhe më shumë para. Atëherë nuk do të thahesh nga rutina, dhe nga shifrat, por do të mbetesh i freskët, si një kek i freskët e pjekur në shtëpi... Kjo është mrekullia e recetës! Të mbushurat, apo garnitura e kekut mund të jenë të ndryshme, por që të jesh e sukseshme raporti i përbërësve të saj duhet të mbetet gjithmonë i njëjlojtë. Kështu nga ekuilibri do të kemi harmoninë: kjo është edhe receta e biznesit.



## TRANSFORMUESE

Nga roli fillestar i të zonjës së shtëpisë mund të kuptojmë një nga detyrat më të rëndësishme të biznesit: detyrën e përhapjes të vlerave, detyrën e transformimit! Në shëmbullin tonë kishim që veprimtaria si zonjë shtëpie dhe zonjë biznesi nuk janë të ndara me thikë. Pra njëri rol përforcon tjetrin. Zonja që permendëm e dinte me saktësi se kë, në ç' mënyrë dhe me çfarë do ti priste shoqet e saj. Çështjet shoqërore veprojnë edhe në argumentat e biznesit. Edhe vetë e dinte, se si mund të dalin justifikime. Por e dinte se fryma e ngrohtë hedh edhe shtratin e biznesit. Po kështu edhe atë, që në vënd të japësh argumenta, shumë herë është më mirë të dëgjosh të tjerët. Në mënyrë instiktive e ndjente se deri ku mund të ecej, dhe kur nuk ka vend për tema biznesi. Po ka edhe një krenarie të heshtur, dhe kjo është vetëdija e jetës të ndërtuar mirë dhe që bazohet tek besimi. Kjo është qetësia e sigurisë që ke shoqe, që do të pranojnë, me të cilat e kuptoni njëra tjetrën dhe që mund ti kesh mbështetje. Sepse edhe ato udhëhiqen po nga ato parime. Edhe ato kanë kuriozitetin e natyrshëm, që baza e zhvillimit është marketingu në rrjet (MLM) Edhe ato kanë krenari, ashtu si edhe modesti – po edhe detyra ndaj shoqeve. Ashtu edhe sot në ndërtimin e rrjeteve nuk kanë rëndësi vetëm pikpamjet profesionale. Suksesi i motivimit dhe i bindjes varet pikërisht nga sjellja personale dhe nga ajo që objektivat e caktuara si i inkuadrojmë në punën e biznesit. MLM që nga fillimet e tij është biznes i transformimit: i shfaqjeve të tua, i dijeve të tua, i të folurit tënd, i festave të tua, i vlerave të gëzimeve që kthehen në vlera biznesi dhe suksesi. Ndërsa si një ndërtues i mirë rrjeti ti transformon vlerat e biznesit, pra ndryshon përsëri: udhëton, lexon, pasuron jetën tënde personale. Pra vajtje-ardhje, në një rrjet ingranazhesh dhe në ingranazh. MLM është përhapje vlerash. Ashtu si amvisa u percjell fëmijëve të saj recetën e gjyshes, duke ruajtur kështu edhe vlerat e vjetra, kështu përcjellim edhe idetë tona, vlerat e qëllimeve tona tek pasuesit tanë. Askund tjetër nuk ka një mundësi kaq të madhe për percjelljen e vlerave sa tek ndërtimi i rrjeteve. Prandaj është e rëndësishme që krahas parasë, mundësinë e jetës së pasur ta arrijmë edhe në këtë kuptim. Në qoftë se i shikojmë me vëmendje, personalitetet e mëdhenj drejtues të MLM, të gjithë janë transformues të shkallës së parë. I lidhin bashkë përvojën, detyrat, gëzimet, njohuritë profesionale, rregullat. Nëpërmjet kësaj ata bëhen misionarë, ndërkohë që nuk nuk zhyten tek problemet sepse për gjithshka mund të gjendet zgjidhja.

## ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Duhet se nuk është njëll që një grup apo një individ të punojë si kërkues i problemeve apo si kërkues i zgjidhjeve. Por në ndërtimin e rrjeteve edhe kjo është gjë e veçantë dhe edhe në këtë fushë mund të kuptojmë diçka nga rëndësia e MLM duke vretur amvisat e shtëpisë. Sa probleme zgjidhin këto amvisa të mrekullueshme që fillojnë shitjen në rrjet? Ato janë mjeshtre. Merren vesh, ruajnë ekuilibrat. Ato nuk përqëndrohen vetë në një rajon të zgjedhur, por ato janë efektive kudo dhe kurdoherë. Pas një ankandi të sukseshëm shtëpiak, atom und të fillojnë perseri. Dhe pse. Amvisa fillon shitjen me një durim të tillë dhe e përgatitur për zgjidhjen e problemit, duke u bërë një partnere e përkryer. Janë mësuar që në çdo situatë dhe që çdo problem duhet zgjidhur, pra zgjidhja duhet të ekzistojë (!) dhe detyra e saj është që ta gjejë atë (!) Familja dhe punët e shtëpisë, shkolla dhe miqtë, detyrat si nënë dhe si grua, dhe nuk kanë justifikime... dhe ekuilibri vetëm atëhere ruhet kur përgjithshka e gjen zgjidhjen. Duke ndërtuar prej gjithshkaje një familje, një jetë dhe me kohë edhe një biznes. Ato kanë qënë krijueset e ekuilibrit, që kanë ditur ti ndajnë paratë, kohën, energjitë, që e dinë sa meriton në kohë dhe në kujdes. Pra e masin me përpikmëri se paraja mund të kthehet në gjithshka, dhe ç'rëndësi ka ajo. E kanë ditur që çdo ditë duhet filluar përsëri punën që të kesh sukses dhe në çdo situatë ju duhet të bëjnë atë që e konsiderojnë të rëndësishme. Dinë të lëshojnë por dinë edhe ku nuk duhet të lëshojnë. E dinë rëndësinë e ndarjes të kohës dhe si duhet të ruajnë energjitë për të gjitha detyrat.

Ka rëndësi të kuptojmë edhe sa praktike janë këto amvisa. Krahas planizimit, ideimit e diskutimeve, mënyra e tyre e jetesës dhe kërkesat ndaj rrethit të tyre bazohen në suksese praktike. Dhe nuk mund të spjegohet suksesi, në qoftë se nuk do ti kishte në rregull punët e shtëpisë. Të qënë natyrë praktike, është një avantazh i madh në ndërtimin e rrjeteve: flet thjeshtë, di të sillet me shifrat, trajton njerzit, ndan kohën... dhe të gjithë këtë e duron me shpirt dhe forcë.

Këto vlera jetojnë akoma tek zonjat e këtij biznesi, në „magjinë e madhe treshe”: ruajtje ekuilibrit, zgjidhje e problemit, transformim. Kjo është baza kryesore dhe më origjinale e MLM modern.

**Andok Ferenc**  
trainues, konsulent për komunikimin



NO LIMITS

## EUROPEAN & WORLD RALLY VIENNA 2011

**N**ga 4 takime Rally të Europës , për herë të tretë marr pjesë si e kualifikuar, por natën para nisjes nuk munda të flija nga emocioni, tashmë e dija se çfarë mbresa të veçanta më presin.

Në mëngjez gjatë një ore pergatita sandviçet për rrugë, por në autobuzin që udhëtonin të kualifikuarit e takimit të vjenës doli që kjo përgatitje kishte qënë e kotë, sepse punonjst e restorantit Sasfészek gjatë gjithë rrugës na kënaqën me sanduçet me haviar, me kek, me fruta, me pijen energjike FAB, kështu që sanduìçet që kisha pergatitur vetë, mbetën „të turpëruar” në çantë. Udhëtimi ynë vazhdoi me biseda të pafund, udhëtarët të gjithë ishin profesionistë, Eagle menaxherë, të kualifikuar të nivelit të 3-të të Rally-it të Vjenës: një shoqëri vërtet e zgjedhur. ndiqja me vëmendje çdo fjalë të tyre, si e regjistruar në një seminar të lëvizshëm Budapest-Vjenë.

Vjena si zakonisht na pret me një elegancë të vecantë, dhe shefi ynë kishte vendosur që vëndi më i mirë për ne do të ishte hotel Intercontinental. Shandanet e kristaltë të prarur plot me ar na bënin të ndjenim luksin e tij dhe përpiqeshin të zbulonin kënaqsinë tonë fëminore.

Mbas dite bashkë me miqtë bëmë xhiro nëper qytet, dhe duke mbetur pak mbrapa po mendoja, sa me fat jam, e rrethuar me njërëz të tillë të mrekullueshëm. Çfarë shansi të madh mora nga jeta, se ishin ata që më formuan mua, që më dhanë gjithnjë objektiva të reja dhe një rend vlerash të veçanta. Ecim si në vals nëper qytet, mrekullohemi me rregullin dhe qetësinë, por mua më shfaqen shënjat e vërteta të takimit që po afron: këtej, andej, gjithkund FOREVERA.

Të premten në mesditë hapen portat, por festivali para Stadthalle duket më tepër sikur jemi në Rio de Zhanero sesa në Vjenë. Miqtë austriakë nuk arrijnë të kuptojnë çështë gjithë kjo rrëmuje sepse në këtë aktivitet janë 12 000 pjesmarrës. Shikoj fytyrat e shokëve të mij, të atyre që marrin pjesë për herë të parë në këto mbresa, se çfarë efekti bën hyrja në këtë sallë të madhe dhe ku para tyre del sheshi plot me kostume kombëtare, me valltarë me një shumicë njerzish që njohen.

Rajoni ynë përfaqshohet nga 1200 vetë. Kurrë nuk e kam ndërë grupin tonë, grupin e Dr. Milesz Sándor kaq unik dhe të mbushur me dashuri. Viti që shkoi e kaliti më tej unitetin tonë, kuptimi i vllazërimit mori përsëri kuptim, sepse në rajonin tonë ekziston vërtet një skuadër që duket që nga larg.

Eshtë gjë e bukur të shikos në fytyrën e Sandorit sa krenar është për ne. Ballona me helium notojnë në sektorin tonë, për ta ndërë si është pergatitur grupi ynë. Çdo takim Rally është një çast i veçantë, kur Rex shfaqet para nesh për herë të parë. Shoh duke mbritur





# VALSET E VJENËS



gjithkënd, por tash në shoqërimin e një prozhektori me drita gjigante shfaqet para nesh Rex dhe bashkëshortja e tij Ruth. Fillon ekstazakoreografi ynë i peerhershëm, miku im Peti Szabó koordinon lëvizjet tona. Eshte një detyrë e madhe të bashkohëshimë shumë njerëz, ata që në habinë e parë as që e vënë re që këtu dotë ketë edhe „punë”. Detyra është që të fitojmë çmimin e skuadrës më të frymëzuar, çmim që jepet në këto takime. Grupi zgjohet nga magjepsja e parë, tashmë thirren menaxherët e rinj dhe të kualifikuarit për rally-in, ata përfaqsojnë vendin tonë në skenë.

Për kënaqsinë tonë të madhe megjithë vështirësitë ekonomike, xhiroja e Hungarisë dhe e rajonit tonë ishte e dyta në Europë! Rezultat i madh, falë këmbnguljes të shumë njerëzve. Pas kuintave kam pas fatin të shikoj punën që ka bërë për këtë aparat i Foreverit dhe Klubi i presidentit.

Atmosfera është e papërshkrueshme- 12 mijë njerëz të lumtur mbushim me energji njerëztrinë dhe në këtë vërshojmë gjatë dy ditëve. Mund të falnderojmë menaxherët tanë, ndërmjet të cilëve Laci dhe Valika Dobai, dhe jemi krenar me ta që kuptuan esencën e sfidës më të re të firmës. Shohim kënaqsinë e tyre, kur Rex u vlerësonte personalisht rezultatit e arritur. Ata janë 8 nga gjenerata e re , për të cilët ja vlen dhe duhet ti ndjekim me vëmendje.

Edhe i kualifikuari ynë si Senior menaxher Attila Sebók si dhe Zlatko e Sonja Jurovic morien shiritin e artë, ndërsa pas tij dolëm në skenë me dy familjet e Eagle Senior menaxherëve Ádám Nagy me Brigi, si dhe Tündé Hajcsik me András dhe persësi munda të ngitem me sulmin e Soaringut, pastaj vjen Profit Share , pas kuintave i bëjmë tifozllëk njeri tjetrit, shperthejnë aktivitetet. Me Tibi dhe Orsi Lapicz qëndrojmë deri në fund, kur po vjen radha e çeqeve. Eshhtë një mbresë e perjetshme dhe një moment të tillë do ta ndash me miqtë më të mirë. Gido një herë pat thënë, se duhet të jesh prezent në një takim me sa më shumë vlerësime. E adhuroj këtë ndjenjë, sepse ishte e tillë sikur të isha në rolin kryesor të një filmi të sukseshëm, ta dini as që mendova për ata që nuk qëndruan me mua. Vetëm jetoja me këto çaste.

Shikoj grupin tonë se si gëzoheshin për sukseset





e njeri tjetrit, bënin foto me çequet, përshëndesnin të kualifikuarit. Në mbrëmje kushdo kërkonte ta kalonte kohën me grupin, sepse kjo është një pervojë e perbashkët me vlera të tilla si në trainimet javore. Në këto çaste shikon se edhe drejtuesit që duket sikur nuk mund tu afroshesh, janë njerëz realë dhe mund ti shikojmë ata jo vetëm në CD apo në skenë, por mund të bësh edhe një foto me ta apo mund të bësh një bisedë që flet për jetën.

Programi i të shtunës nis më herët, është një paradite trainimi. Për mua këto leksione janë një mësim i madh, janë një ballafaqim i mendimeve të yjeve të FLP, se edhe ata mendojnë si ne.

Katrin Bajri na jep ide të shkëlqyera se si mund të përdoren ARGi+ dhe pija FAB në garat sportive dhe mua fillon të më punojë truri se me kë duhet të bisedoj për këtë në Hungari. Një zafir menaxher indian na mëson se si mund të silllemi me miqtë tanë, pastaj pason Lino Barbosa, çudia braziliane që na na bën të kuptojmë Brazilin, se si mund ta bëjmë më mirë biznesin e FLP. Duket se ka një hov të jashtzakonshëm, por sekreti i saj i ngjan sekretit të Gidó. Njerzve u jep ëndërrat. Nqse këtë këshillë ta thonë dy zheni të MLM, a nuk duhet dëgjuar?

Vrulli i Barbosa të merr me vete, por nuk lëvizim as në pushim. Sepse ne kemi ardhur të fitojmë çmimin Spirit Awards. Frymëzohemi edhe nga dreka, dhe si me magnet tërheqim edhe përfaqsesit e vendeve të tjera. Në pushim argëtohen bashkë me ne dhe bashkë këndojmë himnin hungarez. Kaq e kënaqur ndjehem, sikur tani kemi çmimin më të lartë si grup.

Mbasditeja fillon me atmosferën e filarmonisë vjeneze, pas ngjitjes në skenë vazhdon kërcimi, mbasi fituesit e çeqeve Profit Share kërcenjë vals me çequet gjithnjë e më të mëdhenj. Pres sponsorit e mij, megjithse e di se sa më vonë të hypin në skenë aq më të madh e kanë çekun. Me krenari shikoj lumturinë e Tamás dhe Évi Budai pastaj pres edhe të tjerët Pisti dhe Ritá Halmi, Sanyi dhe Ediná Tóth. Duke u rritur vlera e çeqeve aq më

spektakolare bëhet ceremonia. Aranka Vágási dhe familja e saj i bëjnë më magjepsës shifrat me një borie. Në 10-shen e më të mirëve të Europës, Rolph Kipp ishte distributori me rezultatin më të lartë. Në leksionin e tij ai përforcoi idenë se sistemin e vë në funksionim njësia 4-she e ciklit të FLP. Titullimi i diamantëve ishte për mua, çasti më i bukur i Rall-it. Katika dhe Attila Gidófalvi, janë diamantët më të shpejtë në botë. Kur ngjiten të dy në skenë, më duket se vetëm tani po fillon; kaq shumë të kualifikuar kemi parë këto dy ditë. Megjithse Attila thotë në anglisht „If I can do it, you can do it” (Kur munda ta arrij unë, edhe ju mund ta arrini), por deri tani askush nuk e ka arritur këtë titull për një kohë kaq të shkurtër.

Vazhdon titullimi i diamantëve dhe na rreh zemra e na shtërngon emocionin. Miklós Berkics titullohet diamant. Miki flet me modestinë e tij të jashtzakonshme, ai tregon psenë e 14 viteve të shkuara, por më shumë e bëri sepse Rex Maughan e konsideronte atë si djalin e vet dhe Miki mund ta gëzonte atë duke arritur titullin diamant. Nuk kemi shumë kohë për të festuar titullin diamant sepse Mikit i vjen përsëri radha për tu ngitur në skenë: tani ai merr çekun Profit Share me vlerën më të lartë në Europë.

FLP në Europë për 2011 ndan si Profit Share 6,1 milion Euro. Atmosfera e të shtunës mbasdite ishte e papërshkrueshme, ku përziheshin mallëngjimi dhe lodhja e gëzuar me mendimin e ethshëm që e shikoj në fytyrat e njerzve. Shumë kam lënë pa përshkruar, por këtë e kupton ai që ishte vetë atje. Nqse në të ardhmen do të donit të sillni me vete një skuadër të madhe, kam një lajm të gëzuar: Më 2011 organizator i Rally-it European do të jetë BUDAPESTI. Gjithshka ishte si në një ëndërr. Por çfarë duam vërtet, përveçse kur ëndërrat e bukura përputhen me realitetin? Kjo u arrit me sukses.

**Ágnes Klaj**

**Soaring menaxhere, Senior Eagle menaxhere,  
Profit Share menaxhere**

*Lista e plotë dhe portretet e atyre që fituan çequet Profit Share do të botohet në numurin e ardhshëm.*



# ÇASTE NGA WORLD RALLY



